

VENDIM

Nr.126, datë 17.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT, TË KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË KUSHTEVE, QË DUHET TË PLOTËSOJË APLIKANTI, PËR T'U PAJISUR ME LICENCË PËR KAZINO, SI DHE TË RASTEVE TË REVOKIMIT APO TË PEZULLIMIT TË KËSAJ LICENCE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose i huaj, i organizuar si shoqëri aksionare, që kërkon të pajiset me licencë për kazino, duhet të aplikojë pranë autoritetit të autorizuar dhe të plotësojë kushtet e përcaktuara në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar (në vijim referuar si "ligji"), në këtë vendim dhe në aktet e tjera, të dala në zbatim të ligjit.
2. Ministria e Financave është autoriteti i autorizuar, në vijim "Autoriteti", për pajisjen e subjekteve me licencë për kazino.
3. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë vendim do të kenë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligj dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, përveçse kur konteksti e kërkon apo kur, në përputhje me kontekstin e dhënë, në këto akte përcaktohet shprehimisht ndryshe. Plotësimi i kushteve dhe i kriterëve shtesë, të kërkuara për subjektet e huaja, bëhet sipas dokumentacionit të përcaktuar në legjislationin e huaj përkatës.
4. Në këtë vendim, si referencë do të konsiderohet çdo ndryshim ose rimiratim/zëvendësim i aktit, si dhe çdo rregull ose rregullore, nxjerrë në zbatim të atij akti, dhe referencë në një ligj do të konsiderohet referenca në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rimiratuar/zëvendësuar, dhe fjala "ndryshuar" përfshin konceptin "shtuar dhe/ose abroguar".
5. Aplikimi përbëhet nga tërësia e dokumenteve të përcaktuara në këtë vendim, ku përfshihen dhe dokumentet që i kërkojnë aplikuesit nga Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimit (në vijim "Komisioni"), si kusht për shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për licencim, në formën dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
6. Aplikuesi mund të paraqitet në formën e një bashkimi shoqëror, në vijim "Bashkimi", i përbërë nga disa persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj. Bashkimi duhet të caktojë dhe të autorizojë njërin nga anëtarët e tij, si kryesues, për t'i përfaqësuar dhe për të marrë përsipër, në mënyrë të përvokueshme, detyrime në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit për të gjitha çështjet, në lidhje me procesin e shqyrtimit të aplikimit, përfshi dhe licencimin dhe dorëzimin e aplikimit në formën e kërkuar. Anëtari kryesues merr përsipër që bashkimi i përkohshëm të mos ndryshojë përbërjen e tij, pa miratimin paraprak, me shkrim, të autoritetit.
7. Në rast bashkimi, asnjë anëtar i tij nuk mund të marrë pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi në një bashkim tjetër që aplikon për të njëjtën veprimtari.
8. Aplikuesi do të përballojë të gjitha kostot për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit, përfshirë, ndër të

tjera, të gjitha kostot dhe shpenzimet për përgatitjen e përgjigjeve të pyetjeve apo të kërkesave për sqarime a takime të autoritetit.

9. Aplikimi, ku përfshihet dhe e gjithë korrespondenca, dhe dokumentet për këtë aplikim duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe/ose angleze, përveç materialeve të botuara (p.sh.broshurat) të paraqitura nga aplikuesi, të cilat mund të jenë edhe në gjuhë të tjera, por të shoqëruara me përkthim, të vërtetuar në gjuhën shqipe ose angleze.

II. KUSHTET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LICENCË PËR KAZINO

10. Aplikuesi ose, nëse është bashkim, të paktën anëtari kryesues, duhet të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit, të paktën në 3 vitet e fundit të veprimtarisë së tij, për të cilën paraqet një listë të veprimtarive, ku ai zhvillon lojëra fati, së bashku me autorizimet, miratimet apo lejet, në bazë të të cilave i ushtron këto veprimtari. Para dorëzimit të aplikimit, bashkimi i përkohshëm duhet të vërtetohet me një marrëveshje të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe të noterizuar, ku të përcaktohet dhe anëtari kryesues.

11. Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të vërtetojnë origjinën e kapitaleve të tyre, duke paraqitur "Certifikatën e besueshmërisë", dhënë nga organet shtetërore përgjegjëse, që merren me parandalimin e pastrimit të parave të vendeve të tyre, sipas së cilës aplikuesi dhe/ose anëtarët e bashkimit nuk janë dhe nuk kanë qenë në hetim dhe ose të dyshuar për pastrimin e parave.

12. Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, duhet të provojë se ka pasur qarkullim vjetor minimalisht sa 5-fishin e tarifës së licencës për kazino, për secilin prej 3 (tri) viteve të plota financiare, të fundit, duke paraqitur pasqyrat financiare të audituara, të certifikuara nga ekspertë kontabël, për të tri vitet e plota financiare të fundit, përfshirë edhe bilanci e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet shoqëruese.

13. Aplikuesi duhet të paraqesë, së bashku me aplikimin e tij, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga autoriteti, një garanci të aplikimit, në masën 10% të tarifës, që duhet të paguajë për marrjen e licencës. Nëse aplikuesi paraqitet në formën e një bashkimi, garancia e aplikimit duhet të jetë në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit. Garancia e aplikimit sekuestrohet dhe kalon tërësisht në favor të autoritetit, nëse ky i fundit vëren se aplikuesi:

a) ka deklaruar të dhëna të rreme në aplikimin e tij;

b) nuk ka paguar tarifën e aplikimit brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti, në përputhje me këtë vendim;

c) tërhiqet nga kërkesa për shqyrtimin e aplikimit të tij, pasi ky i fundit është paraqitur;

ç) nuk ngurtëson në afatin, shumën dhe formën e kërkuar fondin e ngurtësimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit për lojërat e fatit.

14. Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim, secili prej anëtarëve të bashkimit, duhet të paraqesin aktet e themelimit dhe statutet e tyre, së bashku me certifikatën nga organi që mban regjistrin tregtar në vend, ku të jenë evidentuar emrat e aksionarëve të tyre dhe përqindja që ata zotërojnë në kompani, emrat e aksionarëve, që zotërojnë të drejta të veçanta, emrat e anëtarëve të organeve drejtuese, si dhe të dhëna të tjera për organet drejtuese të tyre, në rast se kërkohet nga autoriteti.

15. Për aksionarët që zotërojnë paketën kryesore të aksioneve, duhet të paraqiten të dhëna personale sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Të dhënat duhet të paraqiten edhe nga të gjithë aksionarët pjesëmarrës në grupin influencues të aplikuesit, sipas

dispozitive të legjislacionit tregtar.

Nëse aplikuesi zotërohet nga një shoqëri, të dhënat duhet të paraqiten dhe për shoqërinë që zotëron aksionet dhe aksionarët e kësaj të fundit, deri tek aksionari që zotëron kontrollin e shoqërisë/shoqërive, që kontrollojnë shoqëritë, që zotërojnë aksionet e aplikuesit.

16. Aplikuesi duhet të paraqesë pasqyra financiare të audituara, të certifikuara nga ekspert(ë) kontabël, për tri (3) vitet e plota financiare të fundit, aty ku është e mundur, përfshirë bilancet e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet shoqëruese për aksionarët e tij ose nëse aplikuesi është një bashkim shoqërisht, për të gjithë aksionarët e anëtarëve të tij.

17. Aplikuesi duhet të paraqesë një vetëdeklarim nga aksionarët e tij dhe anëtarët e organeve drejtuese, që vërteton se nuk është në ndjekje penale, si dhe:

- a) Një dokument që vërteton se aplikanti nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- b) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore;
- c) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore.

Aplikuesi os, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi, ka të drejtë të paraqesë një evidencë për veprimtarinë e ndërmarra nga "Shoqëria mëmë" (siç përcaktohet më poshtë).

17.1 Aplikuesi duhet të paraqesë dokumente për kapacitetet organizative dhe administrative, sipas dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore dhe për numrin e stafit drejtues deri në 3 (tri) vitet e fundit;
- b) Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për të përmbushur kontratën.

18. Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi, ka të drejtë të paraqesë një evidencë pasqyrash financiare të "Shoqërisë mëmë".

19. "Shoqëri mëmë", për efekt të zbatimit të këtij vendimi dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon shoqëritë tregtare, konsiderohet çdo subjekt që kontrollon aplikuesin ose anëtarin kryesues të bashkimit të shoqërive. Përkufizimi "kontroll" nënkupton pasjen e shumicës së votave dhe të shumicës së përfaqësimit në asamblenë e përgjithshme (ose në organe të tjera të ngjashme).

20. Në rast se aplikuesi paraqet përvojat e operimit në fushën e lojërave të fatit dhe ato financiare të "Shoqërisë mëmë", atëherë kjo e fundit do të jetë përgjegjëse solidare me aplikuesin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licencimi. Garancia, në këtë rast, jepet nga organet drejtuese të "Shoqërisë mëmë" që kanë të drejtë të angazhojnë këtë të fundit në të tilla marrëdhënie. Forma dhe përmbajtja e kësaj garancie duhet të jenë të kënaqshme për autoritetin.

III. PROCEDURAT PËR MARRJEN E LICENCËS PËR KAZINO

21. Komisioni refuzon një aplikim, nëse vërtetohet se aplikuesi apo aksionarët e tij janë apo kontrollohen nga shoqëri të regjistruara si "(off shore)".

22. Aplikuesi, që kërkon sqarime për kriteret kualifikuese ose për ndonjë kërkesë tjetër të përcaktuar, mund ta njoftojë me shkrim autoritetin.

23. Çdo aplikues duhet të përgatisë dhe të dorëzojë kopjen origjinale të aplikimit dhe 1 (një) kopje tjetër,

mbi të cilat të vërë qartë shënimin përkatës "Original" dhe "Kopje". Në rast mospërputhjeje ndërmjet kopjes dhe origjinalit, do të merret për bazë origjinali.

24. Origjinali dhe të gjitha kopjet e aplikimit duhet të jenë të shtypura ose të shkruara me bojë që nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi duhet ta nënshkruajnë aplikimin, duke nënshkruar origjinalin e aplikimit dhe duke shënuar inicialet në secilën faqe të origjinalit të aplikimit, me përjashtim të materialeve të botuara.

25. Aplikimi nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të aplikimit.

26. Aplikuesi mbyll kopjen origjinale të aplikimit dhe çdo kopje tjetër në zarfe të veçanta, të nënshkruara "Aplikimi-origjinal" dhe "Aplikimi-kopje". Zarfet vulozen dhe futen në një zarf tjetër më të madh, i cili gjithashtu vulozet. Zarfet e brendshme dhe të jashtme i drejtohen titullarit të autoritetit, në adresën "Ministria e Financave, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.4, Tiranë, Albania dhe mbi to shkruhet "Aplikim për licencë për kazino".

27. Në secilin nga zarfet e brendshme duhet të jenë shënuar qartë emri dhe adresa e saktë e aplikuesit (në rastin e bashkimit, emri dhe adresa e anëtarit kryesues).

28. Komisioni kontrollon aplikimin brenda 20 ditëve nga data e protokollimit të tij, për të vendosur nëse dokumentet janë të plota, të nënshkruara siç duhet dhe nëse plotësojnë kërkesat në përgjithësi.

29. Në rast se dokumentet nuk janë të plota dhe në formën e kërkuar, komisioni i lë një afat deri në 30 ditë aplikuesit, për të plotësuar aplikimin. Dështimi i aplikuesit për të kthyer përgjigje apo për të plotësuar dokumentacionin sipas kërkesës së komisionit, i jep këtij të fundit të drejtën për të refuzuar aplikimin.

30. Komisioni, brenda 60 ditëve nga data e pranimit të shqyrtimit të aplikimit, duhet të marrë një vendim për pranimin apo refuzimin e aplikimit.

31. Nëse dokumentet e kërkuara janë të plota dhe në formën e parashikuar nga ky vendim, komisioni vendos pranimin e aplikimit dhe më pas fillon shqyrtimin e tij.

32. Nëse komisioni, në përputhje me nenin 34/4/d të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, e gjykon të nevojshme që aplikuesi duhet të paraqesë dokumente apo informacione shtesë, i kërkon atij dorëzimin e tyre, duke i përcaktuar një afat të arsyeshëm për plotësimin e informacionit apo të dokumentacionit. Në këtë rast, afati i parashikuar në pikën 25 të këtij vendimi, pezullohet deri në përmbushjen e kërkesave, sipas afatit të lënë nga komisioni.

33. Aplikuesit i lind e drejta për ankim për vendimin e komisionit vetëm për afatin për plotësimin e informacionit apo të dokumentacionit, sipas pikës 27 të këtij vendimi, te titullari i autoritetit, i cili merr vendim brenda 5 ditëve nga marrja e ankimit. Ankimi i aplikuesit nuk pezullon afatin që komisioni i ka lënë në dispozicion aplikuesit.

34. Dështimi i aplikuesit për të kthyer përgjigje apo për të plotësuar dokumentacionin sipas kërkesës së komisionit, i jep të drejtë komisionit për ta refuzuar aplikimin.

35. Çdo aplikim, që nuk i përmbush kërkesat e parashtruara, refuzohet nga komisioni duke humbur edhe të drejtën për t'u marrë në konsideratë për shqyrtim në një kohë tjetër.

36. Autoriteti ka të drejtë të verifikojë çdo informacion dhe dokument të dhënë nga aplikuesi edhe kur aplikuesi është bashkim, për të gjithë anëtarët e bashkimit. Për këtë aplikuesi përfshin në aplikimin e tij, sipas formatit të kërkuar nga autoriteti, një autorizim, që autorizon autoritetin për të bërë, pa asnjë kufizim, verifikimin e dokumentacionit dhe/ose të informacionit të dhënë në aplikim. Dështimi i

aplikuesit për të dhënë një autorizim të tillë sjell refuzimin e aplikimit.

37. Në rast se autoriteti kërkon verifikimin e një informacioni apo të dokumentacionit pranë organeve, që e kanë lëshuar apo tek organet kompetente shtetërore shqiptare apo të huaja, atëherë afati i shqyrtimit të aplikimit pezullohet për kohën që këtyre organeve u duhet për të kthyer përgjigje.

38. Pas shqyrtimit paraprak, komisioni vlerëson imtësisht aplikimin e pranuar, për të përcaktuar nëse përmbush kriteret e kualifikimit, duke pasur parasysh rregullin e mëposhtëm:

a) Kriteret e kualifikimit të përcaktuara në pikat 10 deri 17 të këtij vendimi, bazohen në metodën: "kalon"/"nuk kalon" për secilin kriter.

b) Aplikimi që është pranuar nga komisioni, nisur nga përputhja me kërkesat dhe kriteret e kualifikimit, të përcaktuara nga pikat 10 deri 22 të këtij vendimi, quhet "Aplikim i pranuar".

c) Aplikimi, cilësuar nga komisioni si i papërputhshëm me kërkesat dhe kriteret e kualifikimit, të përcaktuara nga pikat 10 deri në 22 të këtij vendimi, quhet "aplikim i refuzuar".

39. Aplikuesi, aplikimi i të cilit është vlerësuar nga komisioni si "Aplikim i refuzuar", njoftohet nga komisioni brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për refuzim, duke i njoftuar dhe shkaqet e këtij refuzimi.

40. Aplikuesi ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionit për refuzimin e aplikimit të titullari i autoritetit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes njoftim apo nga data kur ai duhet të kishte marrë njoftim. Titullari i autoritetit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankimit, njofton aplikuesin për vendimin e marrë për ankimin e tij, duke argumentuar pranimin apo refuzimin e këtij ankimi.

41. Aplikuesi, aplikimi i të cilit është cilësuar nga komisioni si "aplikim i pranuar", njoftohet nga kryetari i komisionit:

a) për të paguar tarifën e licencës, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke i përcaktuar shumën përkatëse dhe numrin e llogarisë a bankën, ku duhet bërë pagesa;

b) për të dorëzuar fondin e garancisë së fituesit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në formën e një garancie bankare në favor të Ministrisë së Financave, të lëshuar nga një bankë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke i treguar dhe formën dhe përmbajtjen e kësaj garancie;

c) për të dorëzuar dokumentacionin, që vërteton krijimin e shoqërisë, që do të marrë licencën, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 36 të ligjit nr.10/033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim. Në këtë rast ai duhet të plotësojë edhe kushtet e përcaktuara në shkronjat "a" e "b" të kësaj pike.

Nëse aplikuesi është bashkim, ai nuk duhet të ndryshojë strukturën e bashkimit, pa miratimin paraprak, me shkrim, të autoritetit.

42. Nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim dhe në përputhje me shkronjën "c" të pikës 41 të këtij vendimi, do të krijojë një person juridik për efekt të licencimit, atëherë pronësia e aksioneve të personit juridik të krijuar sipas shkronjës së sipërpërmendur dhe çdo ndryshim në pronësinë e aplikuesit dhe ose të aksionarëve të tij, që do të sillte në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë një ndryshim në kontrollin e të licencuarit në krahasim me çastin kur aplikimi është paraqitur, duhet të bëhet me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Financave.

Çdo shkelje e këtij rregulli, i cili është i aplikueshëm si për personat juridikë, të krijuar për efekt të shkronjës "c" të pikës 41 të këtij vendimi, si dhe për çdo aplikues tjetër, që është licencuar sipas këtij vendimi, përbën kusht për revokimin e licencës nga autoriteti.

43. Autoriteti, brenda 5 ditëve nga çasti kur banka ka konfirmuar pagesën në llogarinë e autoritetit dhe

kur aplikuesi ka plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në këtë vendim, i jep aplikuesit licencën për kazino, ku përcaktohen dhe kushtet për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

44. Licenca jepet për një afat 10-vjeçar dhe është e vlefshme nga çasti i lëshimit të saj.

45. I licencuari ka të drejtë ta fillojë veprimtarinë për kazino nga çasti i marrjes së licencës dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 38 të ligjit, të këtij vendimi dhe të legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit, në përgjithësi, në lidhje me kazinotë.

46. Komisioni i shqyrtimit të aplikimit ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit, kryesohet nga zëvendësministri i Financave dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

b) Një përfaqësues nga Ministria e Brendshme;

c) Një përfaqësues nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;

ç) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

47. Komisioni cakton sekretarin e komisionit, i cili merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e komisionit dhe është përgjegjës për protokollimin e mbledhjeve, të vendimeve dhe, në përgjithësi, të korrespondencës me aplikuesit.

48. Vendimet e komisionit janë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij dhe për një vendim të caktuar kanë votuar pro të paktën 3 (tre) anëtarë.

49. Votimi është i hapur dhe nuk lejohet abstenimi. Anëtarët, që votojnë kundër, duhet ta argumentojnë votën e tyre.

50. Përveç sa parashikohet shprehimisht nga ligji nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, titullari i autoritetit revokon licencën e dhënë kur vërtetohet se aplikuesi ka paraqitur në aplikimin e tij një informacion të pasaktë dhe/ose të rremë apo kur në ndonjë çast gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk është në përputhje me kushtet, ku përfshihen edhe ndalimet dhe/ose kufizimet, që ka plotësuar si kusht për marrjen e licencës. Në rast se aplikuesi është bashkim i shoqërive, përputhja me kushtet e licencimit sipas këtij paragrafi shtrihet dhe mbi të gjithë anëtarët e bashkimit.

51. Titullari i autoritetit pezullon licencën, përveç rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe në rastet e mëposhtme, kur i licencuari:

a) nuk ka përmbushur ndonjë nga kushtet e përcaktuara nga legjislacioni për lojërat e fatit;

b) nuk kryen ndryshimet në rregulloren e lojërave dhe të kazinosë, të kërkuara nga autoriteti;

c) nuk ka shlyer detyrimet fiskale brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

52. Titullari i autoritetit, në urdhrin për pezullim, përcakton edhe afatin e pezullimit, i cili nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj nga çasti kur i licencuari ka plotësuar mospërmbushjen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

SHTOJCA 1

VETËDEKLARIM

PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE PËR APLIKIM PËR LICENCË PËR KAZINO

[Datë]

Për: [Ministrinë e Financave/adresa]

[Emri i aplikuesit/anëtari kryesues i bashkimit të përkohshëm] deklaroj dhe garantoj me përgjegjësi të plotë se në datën e këtij vetëdeklarimi:

Z.[Emri i aksionarit për të cilin kërkohet informacion/anëtari kryesues i bashkimit], i datëlindjes..., mbajtës i pasaportës/ID nr., lëshuar nga..., lindur në... banues në..., me adresë:..., nr.tel.:

a) nuk u është nënshtruar procedurave të falimentimit ose likuidimit;

b) nuk është dënuar ose akuzuar për mashtrim, korrupsion, pastrim parash apo pjesëmarrje në vepra penale; dhe

c) nuk ka dijeni për konflikt interesi ekzistues ose për ndonjë konflikt interesi të mundshëm që vjen si rezultat i kontratave ose marrëdhënieve të mëparshme apo atyre ekzistuese, ose çështje që mund të ndikojnë konkretisht në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kontratës së koncesionit.

I juaji sinqerisht,

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Emri dhe pozicioni i nënshkruesit

Emri i aplikuesit/kryesuesit të bashkimit

Adresa